**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr. 04-117/01-0037678/21
Data 27.07.2021

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor**

**Për:** Zyrën Kombëtare të Auditimit

**Nga:** z. Bekim Jashari Kryetar i Komunës së Skenderajt

| PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË JASHTËM |
|---|

| Nr. | Te gjeturat/çështjet | Rekomandimet | Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit | Datat e përcaktuara | Bartësit/ Drejtoritë përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Çështja B1 - Dobësi në definimin e sasive në kontratat publike kornizë**<br><br>Te pagesa në vlerë 15,223€, sipas kontratës publike kornizë "Furnizimi dhe vendosja e kamerave në shkollat e Komunës së Skenderajt" e datës 26.12.2019, në vlerë 32,866€, kemi identifikuar se janë bërë tejkalime në tri pozicione në vlerë 8,144€, ngase në paramasë dhe parallogari të kontratës në këto pozicione ishte evidentuar sasia 1. Tejkalimi mbi sasinë 1 në këto tri pozicione ishte 3430m, 47 dhe 15 copë. Duhet theksuar se dukuria e mos definimit të sasive indikative për kontratat kornizë ishte trajtuar edhe në raportin e auditimit të vitit të kaluar. | **Rekomandimi C1**<br><br>Kryetari të siguroj se gjatë përgatitjes se kontratave publike kornizë të planifikohen dhe të definohen drejtë sasitë për pozicione dhe çmimet e kontratave, në mënyrë që mospërputhjet eventuale mos të tejkalojnë limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%). | - Rritja e kontrollit gjatë përgaditjes së paramasave nga njësitë kërkuese.<br>- Mos inicimi i procedurës nga prokurimi pa definuar saktë llojin e procedurës.<br>- Raport nga menaxheri për përfundimin e kontratës në fjalë.<br>- Kontrolli i dyfishtë para dorëzimit të kërkesës tek operatori ekonomik. | **30.09.2021** | -DKA<br>- Zyra e Prokurimit<br>-Menaxheri i Kontratës |
| 2 | **Çështja A1 - Dobësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave**<br><br>Te aktiviteti i prokurimit "Servisimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Skenderajt", në vlerë indikative 50,000€, njëri nga anëtarët e komisionit | **Rekomandimi A1**<br><br>Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave konform | - Gjatë dorëzimit të kërkesës nga zyra e prokurimit për nxjerrje të vendimit për menaxher do të bashkangjitet një | **30.09.2021** | - Zyra Ligjore<br>- Zyra e Prokurimit<br>- Drejtorat e Drejtorive |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | të vlerësimit të tenderëve ishte caktuar po ashtu edhe si menaxher i kontratës.<br><br>Te aktiviteti i prokurimit "Furnizim me material shpenzues, barna dhe paisje tjera për nevojat e QKMF-së dhe SHPMPF-së në komunën e Skenderajt", në vlerë 103,184€ personi i cili ka përgatitur paramasën ishte caktuar edhe anëtar i komisionit për vlerësimit e tenderëve. | respektimit të kritereve ligjore dhe rregullative të prokurimit publik. | kopje e vendimit të Komisionit.<br>- Zyra ligjore gjatë përgaditjes së vendimit për menaxher të sigurohet nëse personi i rekomanduar nuk është pjesë e komisioneve për procedurën e njejtë.<br>- Mbajtja e regjistrit për personat e angazhuar në hapat paraprak gjatë procesit të prokurimit nga njësitë kërkuese e cila ndihmonë në parandalimin e angazhimit të personit të njejtë në të njëjtën procedurë. | | |
| 3 | **Çështja B2 - Mos respektim i kritereve gjatë vlersimit të aplikacioneve**<br><br>Nga testimi i thirrjeve publike për financimin e projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e sportit dhe kulturës, kemi identifikuar nëntë (9) | **Rekomandimi B2**<br><br>Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike. | - Mos nënshkrimi i kontratave para se të dorëzohet vërtetimi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i | **30.09.2021** | - Drejtori i DKR-së<br>- Komisioni vlerësues |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | raste në të cilat përfituesit janë shpërblyer me kontratë për mbështetje financiare në mungesë të dëshmive se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale. Prej tyre pesë (4) në fushën e sportit. | | projektit nuk janë nën hetime. | | |
| 4 | **Çështja C1 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare**<br><br>Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe, rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes se kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të nenit 21 të Rregullores 02/2013. | **Rekomandimi C1**<br><br>Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat. | - Krijimi i komisionit për inventarizim<br>- Krijimi i komisionit për vlerësim të pasurisë<br>- Komisioni për përgaditjen e ankandit publik<br>- Krijimin e grupit punues më Ministrin e Administratës publike rreth praktikave të funksionimit të E-pasurisë | **30.09.2021** | - Drejtoria për Buxhet dhe Financa<br>- Komisionet e emëruara<br>- Zyrtari i Pasurisë |
| 5 | **Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme (LLA)**<br><br>Pjesa më e madhe e Ll.A i takon tatimit në pronë në vlerë 812,560€ rreth 69%, taksa komunale në biznes në vlerë 243,998€ rreth 21%, dhe shfrytëzimi i pronës publike (renta/qiraja) në vlerë 120,787€ rreth 10%. Komuna nuk | **Rekomandimi B3**<br><br>Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre. | - Dërgimi i vrejtjeve të fundit për Tatim paguesit e mëdhenj<br>- Kushtëzimi i shërbimeve | **30.09.2021** | - Drejtoria për Buxhet dhe Financa<br>- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte rreth 45,920€. Nga analiza e të dhënave të prezantuara në PVF kemi evidentuar se llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në parcela nuk ishin prezantuar fare në PVF. Sipas sistemit Protax vlera e tyre në fund vitin 2020 ishte 80,780€. | | komunale për mos paguesit e TP<br>- Trajtimi i obligimeve të taksave të vjetra të bizneseve nga Asociacioni i komunave dhe përcaktimi i hapave të cilët duhet të ndërmerren.<br>- Shqyrtimi i mundësive për shkëputje të kontratave për mos paguesit e rentës dhe qirasë | | - Drejtora e Gjeodezis dhe Kadastres |
| 6 | **Çështja A2 - Mangësi në listen e detyrimeve kontigjente**<br><br>Në dy raste me vlerë 5,900€ (3,200€ + 2,700€) komuna nuk ka ofruar dokumentet burimore që dëshmojnë pretendimet e palëve tjera ndaj komunës. Ndersa, në një rast tjetër kemi evidentuar se vlera e detyrimit kontigjent ishte paraqitur prej 18,634€, perderisa sipas dokumentacionit kemi vërejtur se duhej të ishte 20,726€. Rrjedhimisht vlera e detyrimit kontigjent ishte nënvlerësuar për 2,091€. | **Rekomandimi A2**<br><br>Kryetari duhet të sigurojë se lista e detyrimeve kontingjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë përkatëse dhe të sakta, në mënyrë që dëshmojnë vlerën financiare dhe të sigurojë pretendimet e tilla kanë të bëjnë me komunën. | - Korigjimi dhe harmonizimi i listës së obligimeve kontigjente<br>- Evidentimi i saktë i kontesteve gjyqësore në të cilat komuna Skenderaj është në proces. | **30.09.2021** | - Zyra e Kryetarit<br>- Avokati i Komunës |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 | **Çështja B4 - Mos kompletimi i NjAB**<br><br>NjAB në Komunën e Skënderajt përbëhet vetëm nga drejtori. | **Rekomandimi B4**<br><br>Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. | - Incimi i procedurave të konkursit për angazhimin e dy auditorve të brendshëm. | **30.09.2021** | |

Menaxheri i aktivitetit/procesit të audituar:

Kryetari i Komunës së Skenderajt

**Bekim Jashari**

_______________, Data: 26.07.2021